

VENDIM
Nr.1545, datë 19.11.2008

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E MBROJTJES, SI AUTORITET KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Mbrojtjes t’i përfundojë, deri në datën 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas tabelave nr.1, nr.2 e nr.3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar, në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Blerje karburanti gazoil - DI (Tender me negocim me shpallje)	195,694,958 lekë
2	Ndërtimi i kaponit Pashaliman	44,135,000 lekë
3	Ushqimi i gatuar në FA (Tender 2-vjeçar)	1,044,608,524 lekë
4	Blerje gazoi F-76 (Tender me negocim pa shpallje)	29.677.808 lekë
5	Blerje vajguri Jet A1 (Tender me negocim pa shpallje)	11.772.900 lekë

Tabela nr.2

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Blerje benzinë për FA	21.853.333 lekë
2	Studime, projekte, hartim të projektit të zbatimit për rikonstruksionin e plotë të SHKU Pogradec	4.766.371 lekë
3	Rikonstruksion ISPMB	11.200.000 lekë
4	Blerje uniformash të ndryshme: - Kostume civile - Bluza liridale detari	8.490.000 lekë 636.000 lekë

Tabela nr.3

Nr.	Emërtimi i objektit	Fondi limit pa TVSH
1	Pajisje për demontim municionesh	145.000.000 lekë

Në tabelën nr.1- Janë vendosur procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë publikuar ende për t’u zhvilluar procedurat e prokurimit.

Në tabelën nr.2 – Janë vendosur procedura të zhvilluara, por që lidhja e kontratës nuk u realizua brenda datës 31.10.2008.

Në tabelën nr.3 - Janë vendosur prokurimet që mund të realizohen në qoftë se do të ketë oferta nga subjekte të ndryshme dhe realizohet procedura me negociim pa shpallje.